ALËSE IZLAZNA-OUTGOING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-20/3
Data Datum Date 17.01.2018

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria - Vlada - Government***
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Për : | Ramiz Lladrovci, Kryetar i Komunës së Gllogocit<br>Labinot Halilaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit | |
| Kopje | Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL<br>Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë | |
| Përmes: | Ivan Todosijević, Ministër i MAPL-së PËR.<br>Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e MAPL-së | |
| Nga: | Fatos Qerimi, Drejtor i Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave MAPL | Datë: 11/01/2018<br>Nr. 020/18 |
| Lënda: | Kërkesë për rishqyrtim të ligjshmërisë se aktit të komunës së Gllogocit | |
| Lloji i aktit: | Vendim i Kuvendit të Komunës | |

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e QRK-së Nr. 01/2016 për Shqyrtimin administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

| |
|---|
| Vendimi Nr. 400/787 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Gllogocit |
| I miratuar më datë më datë: 27.12.2017 |
| I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 55.01.2017 |

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës **<u>është në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi</u>**.

Mos pajtueshmëritë e aktit të komunës të parashtruar për shqyrtim të ligjshmërisë janë si në vijim:

| Nr. | Formulimi në aktin e komunës | Dispozita ligjore me të cilën akti i komunës është në kundërshtim. |
|---|---|---|
| 1. | Vendimi Nr. 400/787 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa në Komunën e Gllogocit | Vendimi Nr. 112/05-190 me të cilin është përcaktuar përbërja e KPF-së prej 7 anëtarëve është në kundërshtim me Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore për arsye të ***"Mos përfaqësimit të barabartë të femrave në këtë trup të kuvendit"*** dhe Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2014 për Themelimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komiteteve të Përhershme në Komunë për arsye të ***"Mos përfaqësimit të entiteteve politike në harmoni me numrin e ulëseve të fituar në kuvend"***<br>Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore në nenin 6 pika 7 dhe 8 ka obliguar:<br>"Organet qe të zbatojnë masa të veçanta për të arritur përfaqësimin e gjinisë më pak të përfaqësuar, deri në arritjen e përfaqësimit të barabartë të femrave dhe meshkujve. Përfaqësimi i barabartë gjinor arrihet kur sigurohet përfaqësim minimal prej pesëdhjetë përqind (50%) për secilën gjini"<br>Udhëzimin Administrativ Nr. 03/2014 për Themelimin, Përbërjen dhe Funksionimin e Komiteteve të Përhershme në Komunë në nenin 6 pika 1 dhe 2 ka përcaktuar se " Përbërja e Komitetit për Politikë dhe Financa duhet të reflektojë përfaqësimin e entiteteve politike si dhe numrin e ulëseve të entiteve politike të përfaqësuar në kuvend". Meqë në kuvendin e komunës së Gllogocit numri i entiteteve politike të përfaqësuar në kuvend është me i madh se numri i anëtarëve të KPF-së atëherë formula e përfaqësimit në këtë komitet obligativ bëhet sipas një renditjes të subjekteve politike duke marrë parasysh numrin me të madh të përfaqësuar në kuvend. |

Bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal kërkon nga Kuvendi i Komunës/Kryetari i Komunës që të ndërmarrin veprime konkrete që aktin e komunës ta harmonizojnë me dispozitat ligjore në fuqi, brenda 30 ditësh nga data e pranimit të kërkesës për rishqyrtim të aktit.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.

DALESE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS VLADA KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-20/3
-VI-
Data Datum Date 17.01.2018

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
*Qeveria - Vlada - Government*
*Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal*
*Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave*
*Ministry of Local Government Administration*

| | | |
|---|---|---|
| Za: | Ramiz Lladrovci, gradonačelnik Opštine Glogovac<br>Labinot Halilaj, predsedavajući Skupštine opštine Glogovac | |
| Kopija: | Jedinici za administraciju dokumenata u MALS-u<br>Jedinici za administraciju dokumenata u opštini | |
| Preko: | Ivan Todosijević, ministar MALS-a, ZA: B. Kurpi<br>Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MALS-a, | |
| Od: | Fatos Qerimi direktor Odeljenja za zakonska pitanja i monitorisanje opština- MALS | Datum, 11/01 /2018<br>Br. 020-20 |
| Predmet: | Zahtev za ponovno razmatranje zakonitosti akta opštine Glogovac | |
| Vrsta akta: | Plan za transparetnost | |

Poštovani gradonačelniče,
Poštovani predsedavajući

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosova br. 01/2016 za administrativno razmatranje akata opština i na osnovu zakonskih ovlašćenja određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 02/2011 o poljima odgovornosti administrativne Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MALS-a, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti akta opštine kako je predviđeno članom 81. Zakona br.03/L-040 o lokalnoj samoupravi kao u nastavku:

| |
|---|
| Odluka br. 400/787 za osnivanje Odbora za politiku i finansije u opštini Glogovac |
| Usvojena dana, 27.12.2017. godine, |
| Predložena za razmetranje u MALS-u dana, 05.01.2018. godine, |

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je isti u suprotnosti sa odredbema zakonodavstva na snazi.

U nastavku možete naći neslaganja opštinskog akta koji je dostavljen za razmatranje zakonitosti:

| Br. | Formulisanje u opštinskom aktu | Zakonska odredba sa kojom je akt opštine u suprotnosti. |
|---|---|---|
| 1. | Odluka br. 400/787 za osnivanje Odbora za politiku i finansije u opštini Glogovac | Odluka br. 112/05-190 sa kojom je određen sastav Odbora za politiku i finansije od sedam (7) članova je u suprotnosti sa Zakonom br. 05/L-020 o rodnoj jednakosti zbog ***"Nejdnake zastupljenosti žena u ovom pomoćnom telu rada Skupštine"*** i Administrativnim uputstvom br. 03/2014 za osnivanje, sastav i funkcionisanje privremenih odbora u opštini zbog ***"Nezastupljenosti političkih zajednica u skladu sa brojem dobijenih mesta u Skupštini"***<br>Zakon br. 05/L-020 o rodnoj jednakosti u članu 6. tačka 7 i 8 je obavezalo da: " Izvršni organi koji i sprovode posebne mere radi postizanja zastupljenosti manje zastupljenog roda, do postizanja jednake zastupljenosti žena i muškaraca. Jednako zastupljene u zakonodavnim organima postiže se kada se obezbeđuje minimalno zastupljenje od pedeset (50) % za svaki rod"<br>Administrativno uputstvo br. 03/2014 za osnivanje, sastav i funkcionisanje privremenih odbora u opštini u članu 6. tačka 1 i 2 odredilo je da: " Sastav Odbora za politiku i finansije treba da odražava zastupljenost političkih predstavnika kao i broj mesta političkih predstavnika u Skupštini. Pošto u Skupštini opštine Glogovac, broj političkih predstavnika je veći od broja članova Odbora za politiku i finansije, onda formula zastupljenosti u ovom obaveznom odboru reguliše se preko rednog broja političkih subjekata imajući u obzir najveći broj zastupljenosti u Skupštini |

Iz gore navedenog, Ministarstvo administracije lokalne samouoprave od Skupštine opštine i gradonačelnika opštine traži da preduzimaju konkretne delatnosti kako bi gore navedeni akt opštine uskladili sa zakonskim odredbama na snazi, unutar predviđenog roka od 30 dana, od dana primanja akta za ponovnu raspravu.

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, ostaje na raspolaganju opštine za daljna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

**REPUBLIKA E KOSOVËS**
**Komuna e Drenasit(Gllogocit)**
Kuvendi i Komunës

Nr.400-787 dt 4.01.2018

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministry of Local Government Administration
Datum 05.01.2018
-VL- 020-20

Në bazë të nenit 51.1,dhe nenit 52 të Ligjit nr.03/L- 040 për Vetëqeverisje Lokale,nenit 4,5 ,6,7pika 5 si dhe nenit 13 të udhëzimit administrativ nr.03/2014, nenit 38.1 të Statutit të Komunës së Drenasit, Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datën : 27.12.2017 mori këtë

VENDIM

Neni 1

Për themelimin e Komitetit për Politik e Financa të Kuvendit të Komunës së Drenasit në këtë përbërje:

1. Labinot Halilaj - Kryesues
2. Gani Podrimqaku
3. Blerina Gashi
4. Burim Bujupi
5. Hamit Kastrati
6. Bedri Nika
7. Petrit Gashi

Neni 2

Komiteti për Politikë dhe Financa i Kuvendit të Komunës zgjidhet për një mandat 4(katër) vjeqar njëjtë sikurse anëtarët e Kuvendit

Neni 3

Komiteti për Politik e Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha çështjeve të parapara më nenin 52.2 Ligjin nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale si dhe nenit 5 të udhëzimit administrativ nr.03/2014 për procedurën e themelimit,përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në komunë.

Neni 4

Mandati i anëtarëve të komitetit për politik dhe financa perfundon më perfundimin e mandatit të anëtarëve të Kuvendit.

Neni 5

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e Miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe vlerësimit të ligjshmerisë nga MAPL-ja 15 dite pas regjistrimit në zyren e protokolit të ministrisë përgjegjse për veteqëverisje Lokale si dhe publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Labinot Halilaj